



SINTEZË E PERIUDHËS 30 MARS – 5 Prill

Qeverisja Demokratike: Një frekuencë dhe shtrirje më e gjerë e mbledhjeve online u vu re gjatë kësaj periudhe duke e çuar numrin në 40 këshilla bashkiakë (KB) që u mbledhën online për të përmbushur funksionin vendimarrës. Monitorimi i grupeve të patronazhit po replikohet në bashki të ndryshme nga KB. Vendimarrja nuk ka të bëjë vetëm me përgjigjen ndaj situatës së krijuar nga Covid-19 por edhe me çështjet e kalendarit. Më e rëndësishme është që 9 këshilla bashkiakë miratuan (rregullore këshilli, rregulloren e konsultimit si dhe kodin e etikës). Bashki të Forta asistoi 16 këshilla bashkiakë në aspekte teknike të vendimarrjes në vesionin online.

Bashkëpunimi Kombëtar-Rajonal-Vendor: Një rritje e bashkëpunimit midis institucioneve rajonale shëndetësore dhe bashkisë u vu re, ku në disa bashki u mor përsipër shpërndarja në shtëpi e barnave për të moshuar apo të sëmurë kronik. Në bashki të ndryshme stafi i saj u vu në funksion të shpërndarjes së pakove ushqimore nga rezervat e shtetit. Gjithashtu ndihmë iu dha postës shqiptare në shpërndarjen e pensioneve. Bashkëpunim midis policisë bashkiake dhe forcave të tjera policore ka ndodhur në zbatim të rregullave të karantinimit të publikut. Prefektura në rastin e Kukësit mori shkas të kërkojë me anë të një shkrese drejtuar bashkive të qarkut, përdorimin e udhëzuesit për mbledhjet online të përgatitur nga Bashki të Forta, si facilitues i punës së këshillave bashkiakë.

Transparencë dhe Llogaridhënie: Është vënë re përdorim i medias sociale për të informuar banorët e bashkive mbi masat dhe njoftimet mbi emergjencën. Media lokale gjithashtu është përdorur gjërësisht për informim të publikut mbi aktivitetin e bashkisë në terren por edhe për mënyrën si mundet të kontaktohet bashkia. Bashkitë raportojnë nëpërmejt faqeve web në formë të strukturuara ose nëpërmjet facebook duke postuar aktivitetet ditore. Policia bashkiake e angazhuan për të informuar publikun në tregje apo dyqane mbi rregullat e distancës sociale

Përmbushje e Funksioneve Vendore: Në përmbushje të shërbimeve sociale bashkitë kanë përdorur fondin e emergjencës gjërësisht ose kanë filluar rialokuar fonde nga programe apo aktivitete të tjera, duke i kaluar fondet për familjet në nevojë apo të moshuarit. Në ndihmë të situatës është vënë re dhe prezencë e ndihmave nga biznese lokale, donatorëve të ndryshëm,

insitucione private si dhe persona privat. Në disa bashki ka filluar asitenca ndaj fermerëve duke i ndihmuar në gjenerimin e lejeve për transportin e produkteve në tregje. Fermerët, si në rastin e Maliqit, kanë vënë mjetet e tyre bujqësore në funksion të dizefektimit.

Kontribut i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqatave të Pushtetit Vendor: Që nga fillimi i emergjencës COVID-19 është parë një rol aktiv i agjencisë dhe shoqatave të pushtetit vendor. Ministria e Brendshme dhe AMVV kanë krijuar grupe pune për të monitoruar zbatueshmërinë e akteve ligjore të harturara si përgjigje ndaj emergjencës. Këto akte dhe baza ligjore i janë shpërndarë të gjithë bashkive. Kontribut është dhënë me hartimin e draft urdhërave dhe draft projekteve për menaxhimin e grupeve të terrenit apo këshillim në lidhje me aspekte të rishikimit të buxhetit apo dhe përdorimit të fondit të emergjencës. Krahas rolit mbështetës të AMMV një aktivitet shtesë është vënë re nga ana e SHAV dhe AAM, me qëllim evidentimin e nevojave specifike nga ana e pushtetit vendor si dhe duke ofruar opsione zgjidhjeje. Në këtë drejtim SHAV është angazhuar për të përmirësuar dhe rritur komunikimin mes pushtetit vendor dhe qeverisë në adresim të situatës duke krijuar një grup interaktiv online. Linja e komunikimit ofroi informacion në kohë reale dhe mundësoi pranimin e sugjerimeve paraqitur MFE, mbi rishikimin e kalendarit buxhetor 2020 dhe procesit publik të diskutimit të buxhetit me pjesëmarrje. Po ashtu propozimi i SHAV për përsheptimin e procedurave të prokurimit është marrë parasysh ku MFE është angazhuar për të përcjellë listen e prioriteteve pranë APP. AAM nga ana e saj ka nisur një fushatë komunikimi në mediat kombëtare duke listuar zgjidhje të mundëshme për pushtetin vendor, duke i adresuar këto sugjerime ndaj Qeverisë Qëndrore. Sugjerimet janë të natyrës ekonomike ku një bashkërendim i kanaleve të dialogut QQ dhe QV të krijohen përsa i përket ndihmës për biznese lokale dhe ekonominë lokale, apo ofrimin e aksesit digjital falas për të gjithë zonat për të rritur komunikimin mes qytetarëve dhe qeverisjes, si dhe duke fragmentuar zinxhireret e infkesioneve. Gjithashtu një sërë sugjerimesh me natyrë të sigurisë dhe kontrollit të territorit të bashkive.

PËR MË SHUMË INFO KOMUNIKO ME KOORDINATORIN RAJONAL:

[Kliko këtu](#)

QEVERISJE DEMOKRATIKE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
<p>Vendimarrja Njohuri të pamjaftueshme të këshilltarëve mbi përdorimin e mjeteve elektronike & pamundësi për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit në kushtet e "distancës sociale"</p>	<ul style="list-style-type: none"> Përdorim i mjeteve elektronike të komunikimit (Skype, e-mail, WhatsApp) dhe asistencë për përdorimin e tyre, 29 këshilla bashkiak të asistuar nga "Bashki të Forta" trajnuar mbi teknologjinë para fillimit të komunikimit. Këto këshilla i janë referuar udhëzimit mbi procedurat e mbajtjes së mbledhjeve në kushtet e përdorimit të mjeteve elektronike (ofruar nga BTF). 	<p>Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Tiranë, Rrogozhinë, Fier, Skrapar, Kurbin, Librazhd, Lezhë, Vlorë, Pogradec, Korca, Kolonje, Devoll, Maliq, Patos, Lushnje, Polican, Cërrik, Kucove, Këlcyra, Vorë, Mat, Klos & Mallakastër, Rokovec, Kukës, Kurbin, Delvinë, Gramsh, Peqin, Berat, Ure Vajgurore, Krujë, Libohova, Gjirokastra, Përmet, Dibër, Bulqizë, Durrës, Shijak, Tepelena, Shkodra (46 total)</p>
<p>Efektet e krizës tek njerëzit në nevojë (veçanërisht gratë) dhe biznesi</p>	<ul style="list-style-type: none"> Shtyrja e afatit me dy muaj për pagesat e taksave dhe tarifave vendore për bizneset. UKT nuk do të aplikojë kamatëvonesa për Shkurtin e në vijim të situatës. Lehtësira fiskale/përrjashtim nga pagesa e tarifës për shërbimet publike (gratë e dhunuara, gratë kryefamiljare me femijë nën 18 vjeç, Familjet e varfra që trajtohen me ndihmë ekonomike, nënat beqare). Përrjashtimi nga pagesa e taksës së ndërtesës (psh ndërtesa për qëllim kulturorë, jo fitimprurëse) për kategori të ndryshme sociale. 	<p>Berat, Lezhë</p> <p>Tiranë</p> <p>Lezhë</p>
<p>Mbikqyrja Monitorimi i grupeve të patronazhit në terren mbi shërbimin që ofrohet</p>	<ul style="list-style-type: none"> Këshilltarët mbikqyrin grupet e patronazhit për pensionistët e vetmuar. 	<p>Këlcyrë, Libohovë, Patos, Lushnje, Shijak, Mallakastër, Divjakë, Roskovec, Kolonjë, Maliq, Pustec, Durrës, Pogradec</p>
<p>Veprime të tjera Aktiviteti i këshillit kufizuar vetëm për aspekte të emergjencës</p>	<ul style="list-style-type: none"> Procedura të njëjta, të lehtësuara, në format elektronike, aplikohen edhe për vendime rutinë si miratimi i rregullore edhe planeve të menaxhimit të mbetjeve (mbështetur nga BTF) Betim online i këshilltarëve të rinj online Këshilltarë të përfshirë në grupet e patronazhit si vullnetarë Krijimi i Komisionit të Rregullores dhe Etikës 	<p>Tirana, Shkodër, Malësi e madhe, Pukë, Fushë Arrëz & Delvinë, Patos, Lushnje, Mallakastër, Maliq, Roskovec, Kukës, Tropojë, Librazhd, Cërrik, Peqin, Krujë, Vlorë, Përmet, Tepelena, Tropojë, Prrenjas, Fier, Bulqizë, (1 bashki ka aprovuar plan menaxhimi mbetjesh online)</p> <p>Dropull, Vlorë</p> <p>Lezhë, Gjirokastrë, Dropull, Memaliaj, Tepelenë, Libohovë, Përmet, Këlcyrë, Shijak, Kurbin, Mirëditë, Durrës, Pogradec, Kolonjë, Maliq, Lushnje</p> <p>Tiranë</p> <p>Shijak</p>

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR-RAJONAL-QEVERISJE VENDORE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
Aksesi i qytetarëve tek shërbimi i barnave të rimbursueshme	<ul style="list-style-type: none"> Skemë bashkëpunimi me qendrat shëndetësore dhe ambulancat për shpërndarjen e ilaceve në shtëpitë e të sëmurëve Bashkia ofron koordinim në terren me sinjalizimin e nevojës për shërbim mjeksor sipas rastit, mes stafit mjeksor të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe shtresave në nevojë (kryesisht të moshuarëve). 	Pustec, Dropull, Tepelenë, Libohovë, Gjirokastrë, Memaliaj, Ura Vajguore, Tropojë, Has, Kukës, Kolonjë Diber, Bulqize, Klos, Mat
Ofrimi i ndihmës për shpërndarjen e bazës ushqimore për shtesat në nevojë apo moshat e treta	<ul style="list-style-type: none"> Grupet vullnetare të ngritura nga bashkitë ndihmojnë në shpërndarje e pakove ushqimore nga rezervat e shtetit. Qeveritë studentore pjesë e këtyre nismave. Bashkitë arrijnë tek rastet me nevoja të veçanta përmes linjës kërkesë-ankesë instaluar në prefekturë, portalit shqipëriaqëduam si dhe linjave të gjelbërta. 	Kurbin, Lezhë, Divjake, Lushnje, Patos, Roskovec, Durrës, Shijak, Krujë, Elbasan, Vlorë
Identifikimi i njerëzve në nevojë	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i linjave të gjelbërta nga qytetarët me kërkesa dhe ankesa ndihmon bashkitë në evidentimin e njerëzve në nevojë dhe ofrimin e ndihmës pas verifikimeve nga grupet e emergjencave. Bashkitë përditësojnë listat e tyre të të moshuarve të vetmuar në koordinim me zyrat postare, ku familjarët apo të afërmit depozitojnë ID ose librezave të pensionit si dhe adresën e tyre për dërgimin në banesë të pensionit ose marrjen e ndihmave. Bashkitë fillojnë t'i paraprijnë hartimit të listave për fashat e njerëzve që mund të dalin të papunë (kontingjent i mundshëm i shtresave në nevojë për efekt ekonomik). 	Ura Vajguore, Diber, Divjakë, Lushnje
Koordinim për veprim efektiv	<ul style="list-style-type: none"> Bashkëpunim me policinë për lejimin/informimin e fashave të lejes për fermerët dhe blegtorët që duhet të vazhdojnë punën në ekonomitë e tyre private Koordinim i efektiv i zinxhirit prefekt-këshill-administratë për konfirmimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak duke ofruar edhe udhëzime dhe urdhëra për vendimarrje në përputhje me luadrin ligjor 	Kolonjë, Devoll, Maliq Qarku Korçë

TRASPARENCË, NDËRGJEGJËSIM DHE LLOGARIDHËNIE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
Informacion i mjaftueshëm për të përfutur shërbimet publike	<ul style="list-style-type: none"> Transmetim live i mbledhjes së këshillit bashkiak në platforma të medias sociale dhe në TV lokale në respektim të udhëzimit të BTF Përdorim i medias lokale për trajtim ankesash online (e-mail). 	Shkodër Kukës, Berat, Tepelena, Progradec Korce, Kolonje, Pogradec, Pustec, Devoll, Maliq, Durrës, Shijak, Krujë, Shkodër
Nxitje e Vullnetarizmit	<ul style="list-style-type: none"> Thirrje nëpërmjet FB ndaj qytarëve, të atashohen si vullnetarë në njësinë administrative ku jetojnë, si dhe nisma për vullnetarë të angazhuar në përkujdesjen ndaj të moshuarve (Adopto një Gjysh etj); përdorim i medias sociale për të promovuar emrat e dhuruesve. Vullnetarë të angazhuar për të mbështetur bashkinë në shpërndarje ndihmash apo blerje ushqimesh dhe ilacesh Bashkia krijon forma online dhe aplikacione për ndihma apo shërbime nga bashkia apo sektori privat. 	Gjirokastër, Klos, Lezhë, Kukës, Has, Tropojë, Durrës, Dibër, Bulqizë, Klos, Mat, Tirana, Korçë, Berat Kukës, Lezhë, Shkodër, Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrës, Pogradec, Kukës, Mat, Dibër, Bulqizë, Klos, Fier, Kolonjë, Kurbin, Has, Tropojë, Roskovec, Patos, Mat, Bulqizë, Dibër, Klos, Librazhd, Prrenjës, Dropull Tirana (Aplikacion, Nr, Gjellbër) Kukës
Informim i publikut mbi punën dhe masat e mara në nivel bashkie	<ul style="list-style-type: none"> Raportim i punës së zhvilluar nga të gjitha strukturat e bashkisë ofrohen në faqen e facebook-ut dhe medias locale. Kërkohej transparencë për publikun nga Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore në raport me ndihmat e marra nga rezervat e shtetit për muajin Mars. Ndergjegjësimi i komunitetit nëpërmjet artistëve të Qytetit. Artistët bëjnë shfaqje live për të ndërgjegjësuar banorët nga faqja e bashkisë ose terren. 	Pukë, Malësi e Madhe, Fushë Arrës, Vau i Dejës, Shkodër, Durrës, Shijak, Krujë Shkodër Berat, Lezhë, Durrës

PËRMBUSHJA E FUNKSIONEVE VENDORE

Problemi	Modalitetet e zgjidhjes	Ku ka ndodhur suksesshëm
Shërbimet Sociale Fonde te pamjaftueshme për të përballuar emergjencën COVID me burimet e alokuara financiare në buxhetet vjetor (veçanërisht në mbështetje të shtresave në nevojë)	<ul style="list-style-type: none"> Mbështetje e familjeve në nevojë, rome/egjiptiane apo ato të goditura nga tërmeti, me ushqime dhe materiale të nevojshme të ofruara nga fondet e bashkive, donacione private ose fetare (Fondacioni Ndihmë për fëmijët, Kryqi i kuq, Uji i ftohtë, Nehemia Gateway, CFN Albania, Save the Children, A2B Albania, World Vision, La Luce dell'est dhe Rrahma Mercy, ROMACTED) 	Lezhë, Berat, Lushnje, Pogradec, Pustec, Durrës, Elbasan, Patos, Mallakastër, Dibër, Krujë, Përmet, Shkodër

<p>Ofrim shërbimesh sociale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndarje lëndë drusore tek komuniteti Rom në kushtet e temperaturave të ulta • Shpërndarja e mesazheve sensibilizuese për dhunën në familje, në kohën e COVID-19 dhe ofrimi i numrave të punonjësve social të bashkisë për denoncime apo ndjekje rastesh • Ndërtim i një sistemi bashkëpunimi bashki, biznes, personat në nevojë dhe vullnetarë, ku banorë në zona të izoluar malore bëjnë porosi tek biznesi për mallra ushqimore dhe joushqimore, ilaçe dhe bashkia mundëson transportin e tyre. • Seanca të asistimit të psikologut dhe punonjësit social të bashkisë online dhe telefon si dhe këshillim për terapi në distancë për fëmijë me probleme zhvillimore dhe raste në nevojë (mbështetur nga BtF). 	<p>Dibër</p> <p>Dibër, Klos, Malesi e Madhe, Fushe Arrez, Shijak, Lushnje, Selenicë, Himarë</p> <p>Pukë</p> <p>Durrës, Dibër, Shkodër</p>
<p>Evidentimi i familjeve në nevojë dhe dërgimi i listave pranë Komitetit të Emergjencave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i procedurave të brendshme për menaxhimin e zinxhirit të shpërndarjes së ndihmës duke u siguruar për evidentimin e njerzëve në nevojë dhe parandalimin e zinxhirit të infeksionit. Bashkitë bëjnë transparente shpërndarjen e ndihmave në këshill dhe publik. • Solidarizim i konsiderueshëm i emigrantëve, bashkëatdhetarëve dhe bizneseve duke grumbulluar surplus ndihmash. • Vullnetarë të angazhuar në evidentimin e nevojave qytetare duke trokitur derë më derë • Fondi i caktuar për aktivitetet social-kulturore apo programe që mbulojnë shërbimet publike vendore (investime për sheshe, ujësjelles etj) është rialokuar për familjet në nevojë. 	<p>Shkodër, Dibër, Kukës, Has, Tropoje, Durrës, Shijak, Krujë, Mallakstër, Patos, Roskovec</p> <p>Mat, Kukës</p> <p>Kukës</p> <p>Kukës, Gjirokastrë, Lezhë</p>
<p>Zhvillimi Ekonomik Kushtet për lehtësimin e prodhimit vendas Lehtësimi i transportit për fermerët (biznesin e vogël)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje e sektorit të bujqësisë (nevoja për të nxitur produktin vendas në kushtet e vështirësisë) duke asistuar në furnizim të bazës ushqimore për bagëti. • Asistim fermerësh me aplikim për leje udhëtimi të vlefshme për transportin e ushqimit të blegtorisë . Specialistët e Drejtorisë Bujqësisë ndihmojnë fermerët në zbatimin e procedurave 	<p>Maliq, Mat, Kolonjë, Devoll, Fier</p> <p>Roskovec, Memaliaj, Vlora, Kukësi, Kolonjë</p>
<p>Siguria Publike Përbushja e detyrave funksionale edhe në kohë emergjence</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Koordinimi i punës së Drejtorisë së Shërbimeve me Komisionin e Mbrojtjes Civile për hapjen e rrugëve nga dëborat dhe përballimin e situatave duke bashkërenduar me grupet e patronazhit të ndarë sipas njësive 	<p>Mat, Bulqizë, Dibër, Klos, Kukës, Has, Tropojë, Qarku Dibër, Qarku Lezhë –</p>

- Transport i dedikuar për stafin mjeksor në bashkëpunim me operatorët e transportit public Kamez, Tirana, Vlorë

Shërbime publike

- Mbështetje e shtuar financiare për sektorin e mbetjeve në përgjigje të situatës së shkaktuar nga COVID-19. Dibër, Sarandë, Gramsh, Librazhd, Prenjas Bulqizë

Veprimtari që vjiojnë si normalisht përtej COVID-19

- Pastrimi i disa vend depozitimeve ilegale të mbetjeve në njesite administrative. Përdorimi i situatës për të mbyllur punë publike infrastrukturore apo mirëmbajtje në kushtet e lëvizjes dhe transportit të lehtësuar nga COVID-19 (sheshe, trotuaresh) Mat, Dibër, Durrës, Shijak

Aktivitete Zbavitëse

- Konkurs kreativiteti i fëmijëve në bashkëpunim me median lokale, apo zhvilluar online nëpërmjet medias sociale dhe autoritete të kulturës. Lezhë, Vlorë, Klos, Dibër, Kukës, Pogradec,
- Edukatorët e kopshteve ofrojnë orë zbavitëse për fëmijët përmes medias online në bashkëpunim me prindërit. Durrës

Shënim*: Me ngjyrë të kuqe janë bashkitë që janë shtuar apo që po replikojnë një praktikë të vënë në jetë më parë nga bashki të tjera.

Shënim:** Një falenderim i veçantë shkon për mediat kombëtare apo lokale që e kanë shpërndarë raportin si dhe kanë evidentuar zgjidhjen e dhënë nga bashkitë për problematikat e krijuara gjatë emergjencës COVID-19.